

20141785545

LIGJ PËR GARANCI TË REPUBLIKËS SË MAQEDONI-SË TË OBLIGIMEVE SIPAS MARRËVESHJES PËR HUA PËR FINANCIM TË PROGRAMIT PËR RRUGË NACIONALE, E CILA DO TË LIDHET NDËRMJET BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM DHE NDËRMARRJES PUBLIKE PËR RRUGË SHTETËRORE

Neni 1

Republika e Maqedonisë e garanton përbushjen e obligimeve dhe përbushjen e dispozitave të Marrëveshjes për hua për Programin për rrugë nacionale e cila do të lidhet ndërmjet Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore në shumë prej 160 000 000 euro, nëse Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore nuk i përbush dhe servison obligimet nga Marrëveshja për hua.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas përcaktohen me Marrëveshje për hua nga neni 1 i këtij ligji, e cila do të lidhet ndërmjet Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore për financim të Programit për rrugë nacionale.

Neni 3

Të gjitha obligimet të cilat dalin nga Marrëveshja për hua nga neni 1 i këtij ligji, si dhe servisimin e huas do ta kryejë Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore nga të hyrat të cilat i realizon, në afate dhe kushte të përcaktuara në Marrëveshjen për hua nga neni 1 i këtij ligji.

Neni 4

Afati për pagesën e huas nga neni 1 i këtij ligji është 15 vjet me grejs periudhë të përfshirë prej katër vitesh.

Shkalla e kamatës është variabile dhe përbëhet nga EURIBOR gjashtëmujor i zmadhuar për margjinë prej 1%.

Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore do t'i paguajë Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim provizion të njëhershëm në lartësi prej 1 % nga shuma e transhës së parë në afat prej shtatë ditësh nga dita e efektivitetit të transhës.

Në afat prej shtatë ditësh nga dita e qasjes për shfrytëzim të transhës së dytë Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore do t'i paguajë Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim provizion të njëhershëm në lartësi prej 1 % nga shuma e transhës së dytë.

Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore do t'i paguajë Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim provizion për mjete të patërhequra në lartësi prej 0,5% nga huaja në nivel vjetor.

Për shumën e mjeteve të patërhequra nga huaja për transhën e parë provizioni do të fillojë të llogaritet pas 60 ditësh nga dita e nënshkrimit të Marrëveshjes për hua nga neni 1 i këtij ligji, ndërsa provizioni për mjete të patërhequra për transhën e dytë do të fillojë të llogaritet pas shtatë ditësh nga dita e qasjes për shfrytëzim të transhës së dytë.

Neni 5

Për rregullimin e të drejtave dhe obligimeve të ndërsjella që dalin nga Marrëveshja për hua nga neni 1 i këtij ligji dhe Marrëveshja për garanci, Ministria e Financave dhe Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore do të lidhin marrëveshje të veçantë.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".